



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

Lënda: Njoftim për 5(pesë) vende të lira pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ në Rektoratin e Universitetit të Tiranës

Drejtuar: **Znj. Reida Kashta**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik**

Rektorati i Universitetit të Tiranës shpall konkursin për **5(pesë) vende të lira pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ, si më poshtë vijon:**

1. Drejtor i Drejtorisë së së Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë;
2. Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Studentët;
3. Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Studentët;
4. Specialist në Sektorin e Sigurimit të Cilësisë;
5. Specialist në Sektorin Juridik.

Kandidatët konkurrentë për vendin e lirë të punës për personel ndihmës akademik me karakter administrativ me detyrë **“Drejtor i Drejtorisë së Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë”**, në Rektoratin e UT-së, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme:**

1. Të jenë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master i Shkencave" ose diplomë ekuivalente me të. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta:**

1. Të kenë eksperiencë pune në IAL jo më pak se 5 vite, në fushën e marrëdhënieve me jashtë, shkrim/zbatim projekti.
2. Preferohen kandidatët që kanë Grada/Titujt shkencorë;
3. Preferohen të kenë eksperiencë në programet Europiane (Erasmus +, Horizon Europe, etj.);
4. Të njohin shumë mirë legjislacionin në fuqi, preferohet atë në arsimin e lartë;
5. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit;
6. Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze, e provuar me dëshmi;
7. Të kenë aftësi shumë të mira organizacionale, komunikimi, etikë profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

Kandidatët konkurrentë për vendin e lirë të punës për personel ndihmës akademik me karakter administrativ “**Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Studentët**”, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët, në Rektoratin e UT-së, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master i Shkencave" ose diplomë ekuivalente me të në Marrëdhënie me Publikun. Diplomat e nivelit "Bachelor" duhet të jenë në drejtimin Gazetari – Komunikim. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta**:

1. Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite, preferohet eksperiencia e punës në fushën e marrëdhënieve me publikun, studentët;
2. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, të provuara me dëshmi;
3. Të njohë me dëshmi gjuhën angleze. Njohja e gjuhëve të tjera të huaja përbën përparësi;
4. Të kenë aftësi shumë të mira organizacionale, komunikimi, etikë profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

Kandidatët konkurrentë për vendin e lirë të punës për personel ndihmës akademik me karakter administrativ me detyrë “**Specialist**” në Sektorin e Marrëdhënieve me Studentët, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët, në Rektoratin e UT-së, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master i Shkencave" ose diplomë ekuivalente me të në Marrëdhënie me Publikun. Diplomat e nivelit "Bachelor" duhet të jenë në drejtimin Gazetari – Komunikim. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta**:

1. Të kenë eksperiencë pune të paktën 1 vit;
2. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, të provuara me dëshmi;
3. Të njohë me dëshmi gjuhën angleze. Njohja e gjuhëve të tjera të huaja përbën përparësi;
4. Të kenë aftësi të mira komunikimi, etikë profesionale dhe të dijë të punojë në dëshm grup.

Kandidatët konkurrentë për vendin e lirë të punës për personel ndihmës akademik me karakter administrativ “**Specialist**” në Sektorin e Sigurimit të Cilësisë, pranë Drejtorisë së Kurrikulave

dhe Sigurimit të Cilësisë, në Rektoratin e UT-së, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master i Shkencave" ose diplomë ekuivalente me të. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të zotërojnë me dëshmi të paktën një nga gjuhët e huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
4. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
5. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta**:

1. Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune në fushën përkatëse;
2. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, të provuara me dëshmi;
3. Të ketë njohuri shumë të mira të Ligjit të Arsimit të Lartë;
4. Të kenë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të dinë të punojnë në grup.

Kandidatët konkurrentë për vendin e lirë të punës për personel ndihmës akademik me karakter administrativ "**Specialist**" në Sektorin Juridik, pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, në Rektoratin e UT-së, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme**:

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë të paktën një diplomë të nivelit "Bachelor" ose diplomë ekuivalente me të në Drejtësi. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të jetë bërë njohja e tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta**:

1. Preferohet të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit;
2. Të njohin shumë mirë legjislacionin në fuqi, preferohet atë në arsimin e lartë;
3. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, të provuara me dëshmi;
4. Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze, e provuar me dëshmi;
5. Të kenë aftësi të mira komunikimi, etikë profesionale dhe të dijë të punojë në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Curriculum vitae;
3. Diplomë e studimeve universitare (fotokopje e noterizuar). Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopja e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent;
4. Të paktën dy referenca nga punëdhënësit e mëparshëm;
5. Dëshmi penaliteti;
6. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (fotokopje e noterizuar);

7. Dëshmi që të vërtetojë njohuritë bazë të përdorimit të kompjuterit (fotokopje e noterizuar);
8. Kopje të librezës së punës (fotokopje e noterizuar);
9. Raport mjekësor për aftësinë në punë.

Dokumentat prahen në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, nga data **15.11.2021 - 29.11.2021**. Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

**REKTORI**

**Prof. Dr. Artan Hoxha**